



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
TË MBAJTUR MË 5.04.2017**

T R A N S K R I P T

**SA JAVNE RASPRAVE KOMISIJE ZA EKONOMSKI RAZVOJ,
INFRASTRUKTURU, TRGOVINU I INDUSTRIJU
ODRŽANE 5. 04. 2017 GODINE**

PRILL, APRIL 2017

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, z. Muhamet Mustafa

KRYETARI: Të nderuar të pranishëm,
Kam kënaqësinë që në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik Infrastrukturë Tregti dhe Industri të ju përshëndes të gjithëve, të ju falënderoj që jeni përgjigj thirrjes për këtë dëgjim publik lidhur me Projektligjin për shoqëritë tregtare.

Përshëndes ekspertë nga puna e bashkuar, përshëndes përfaqësuesit e ministrisë dhe ministrive tjera, përfaqësues të USAID-it që kanë dhënë një asistencë profesionale, përfaqësues të mediave dhe të shoqërisë civile, gjithashtu edhe kolegët e mijë nga Komisioni deputeten Sala Berisha Shala dhe deputetin Raif Çela.

Qëllimi i tubimit të sotëm është që të shkëmbejmë mendimet lidhur me projektin e Ligjit për shoqëritë tregtare që na ka ardhur si projekt integral për arsye se ministria ka konsideruar që kanë ekzistua edhe përpara 2-3 ndryshime dhe plotësime edhe me qenë se janë disa risi në këtë e kanë preferua më tepër që të kenë një ligj të ri për shoqëri tregtare edhe pse janë shumë dispozita të ligjit të përparmë e kemi këtu po thuaj se të pandryshuara.

Ne e kemi trajtua këtë projektligj në Komision dhe për këtë projektligj është debatua në seancë të Kuvendit dhe në parim ky ligj është aprovua, ka shkua në diskutim në mënyrë që midis dy seancave para leximit të dytë të konsultohen gjithë akterë të interesuar dhe të bëhet amendamenti në ato pjesë të ligjit të cilat kanë nevojë për një përkufizim më të mirë ose për një rregullim më të mirë.

Ajo që ne kemi konsiderua të rëndësishme në këtë projektligj është se edhe më tutje i përsos për mos me thanë i rregullon edhe më mirë procedurat e regjistrimit. E dyta, krijon një rregullsi më të madhe për identifikimin e bizneseve me një numër të vetëm. E treta, futë edhe këtë regjistrimin elektronik. E katërta, avancoon qeverisjen korporatave edhe investitorët e vegjël pozitën e tyre qeverisjen korporatave.

E këto janë disa risi të rëndësishme për neve por sot do të bisedojmë pra pak më shumë. Qëllimi jonë është që të ju dëgjojmë më tepër juve, keni me pas fjalën më tepër të ftuarit tjerë, ekspertë dhe përfaqësues të bizneseve në mënyrë që Komisioni pastaj grupi punues t'i formuloj amendamentet sipas nevojës.

Para se të kalojmë në diskutim, unë kisha kërkuar prej përfaqësuesve të ministrisë të bëjnë një prezantim të shkurtë të këtij ligji. Urdhëroni!

REMZIJE HAJDARI: Unë jam Remzije Hajdari, jam përfaqësuese e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Departamenti Ligjor.Faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëmarrës,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si bartëse e këtij projekti legjislativ shkurtimisht të paraqes rëndësinë, qëllimin dhe fushën e rregullimit dhe përmbajtjen në pika të shkurta të këtij projektligji.

Arsyeja për hartimin e Projektligjit për shoqëritë tregtare është adresimi i nevojës për afrimin e ligjit ekzistues për shoqëritë tregtare me ndryshime dhe plotësime me legjislacionin e BE-së në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, MSA-së dhe planit të zbatimit për MSA.

Arsye tjetër e ndryshimit të këtij projektligji është përcaktimi i rregullave që ndikojnë në mbrojtjen e investitorëve të vegjël në korporata si dhe përmirësimi dhe thjeshtësimi i mëtutjeshëm i procedurave për regjistrimin e shoqërive tregtare duke bazuar në kërkesat dhe metodologjinë e Bankës Botërore në raportin për të bëjë biznes respektivisht indikatorët, fillimi i një biznesi dhe mbrojtja e investitorëve të vegjël.

Po ashtu me këtë projektligj është krijuar baza ligjore për krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të raportimit të performancës së regjistrimit të shoqërive tregtare nëpërmjet hartimit të raporteve të rregullta të cilat paraqesin një pasqyrë të shërbimeve të regjistrimit të shoqërive tregtare. Duke përfshirë të dhëna si koha që nevojitet për regjistrimin e një shoqërie tregtare, numri i shoqërive tregtare të regjistruara dhe të çregjistruara, shoqëritë tregtare të regjistruar në bazë të gjinisë si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me azhurnimin e të dhënave në fushën e mirëmbajtjes dhe regjistrimit të bizneseve.

Si dispozita tjera ligjore me rëndësi të mëdha të cilat do të kenë ndikim në përmirësimin e ambientit të bërit biznes në Kosovë janë dispozita të cilat përcaktojnë krijimin e numrit unik identifikues për shoqëritë tregtare. Sipas këtyre dispozitave shoqëritë tregtare të cilat regjistrohen në ARBK jepet një numër unik i cili i identifikon shoqëritë tregtare para të gjitha institucioneve të Administratës Shtetërore të Kosovës si ARBK, ATK, Dogana e Kosovës e të tjera. Me anë të këtij numri shoqëria tregtare do të regjistrohen në ARBK dhe po i njëjti numër do t'i shërbej shoqërisë tregtare për ndërveprim me ATK-në për deklarimin dhe pagesën e tatimeve si dhe për lëshimin e certifikatës së TVSH-ve.

Projektligji po ashtu trajton edhe regjistrimin elektronik të shoqërive tregtare, si një hap i rëndësishëm për lehtësimin e procesit të regjistrimit të shoqërive tregtare. Kjo do të lehtësoj regjistrimin e shoqërive tregtare nga aksionarët e huaj, gjë që ndikon në përmirësimin e mjedisit për investime të huaja.

Projektligji për shoqëritë tregtare është paraparë në programin kombëtarë për zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe PZ për MSA-në, planin e punës së Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe programin legjislativ të Qeverisë në Republikën e Kosovës për vitin 2017. Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren numër 09/2011 për punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar deklarata financiare nga Ministria e Financave se nuk ka implikime buxhetore dhe opinionin e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së nga Ministria e Integritimit Evropian se projektligji është i harmonizuar me acuin e BE-së.

Ju falënderoj për vëmendje, për pyetje do të jem këtu të pranishëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ju faleminderit shumë për këto vërejtje hyrëse.

Po hap diskutimin lidhur me tekstin e projektligjit. Urdhëroni!

DARDAN ABAZI: Faleminderit!

Dardan Abazi, Instituti për Politika Zhvillimore INDEP.

E përshëndes mbajtjen e këtij dëgjimi,

Mendoj që është praktikë shumë e mirë dhe sidomos prej Komisionit për Zhvillim Ekonomik që po mban dëgjime publike për një numër të konsiderueshëm të ligjeve e ne mendojmë që duhet të mbahet për të gjitha ligjet dhe insistojmë që të ketë më shumë dëgjime publike.

Projektligji i propozuar është tejet voluminoz edhe ka përfshirë shumë elemente që ne konsiderojmë që në një masë të tyre dhe nuk ka pasur nevojë të përfshihen për shkak se po e ritë shumë volumin e ligjit dhe po e bënë vështirë të analizueshëm, për shembull nuk duhet të ketë dy nene, nenet 11 dhe 12 dy nene të veçanta vetëm për të thënë që punëtorët e ...-së në Qendër dhe komuna janë nëpunës civilë sepse konsiderojmë që kjo është e nënkuptueshme dhe nuk ka nevojë të komplikohet edhe të plotësohet ligji aq shumë sa të shkoj deri në 400 faqe.

Mendojmë që ky ligj është tejet i rëndësishëm dhe si i tillë nuk duhet të vlerësohet dhe të konsiderohet me ngutë e mendojmë që Ministria nuk duhet të bëjë gabimin e të kaluarës që gjithë agjendën e vetë ta fokusoj në përmirësimin e ... por duhet me të vërtetë të punojë në përmirësimin e kushteve të të bërit biznes në praktikë që përfshinë jo vetëm procedura teknike të regjistrimit por edhe shumë elemente të tjera.

Mendojmë që tek qëllimi i ligjit, konsiderojmë që nuk duhet përfshirë lista e direktivave që ligji ka përfshirë në qëllimin e ligjit, ato duhet sqaruar në memorandumun shpjegues e për më tepër kur thuhet që ky ligj është pjesërisht në përputhje me direktivat kjo, kjo duhet shpjegohet saktësisht çka nënkuptohet me pjesërisht, çka është lënë nga direktivat plotësor sepse është normale që jo gjithçka të kontekstalizohet në kontekstin e Kosovës.

Por mendojmë që këto sqarime shtesë duhet dhënë në memorandumun shpjegues e jo në qëllimin e ligjit sepse po i bije që qëllimi në vetvete i ligjit është përafrimi me legjislacionin evropian e ne konsiderojmë qëllimi në vetvete nuk duhet të jetë ky por që përmes përafrimit të mërihen qëllimet e përmirësimit të bërit biznes, rritjes ekonomike e të tjerë.

Tek neni 10, janë heq dy standarde shumë të rëndësishme që kanë qenë në nenin 8 të ligjit aktual udhëheqësit të zyrës së regjistrimit e tani të drejtorit të ARBK-së, aty ka qenë përvoja e punës prej 5 vjet përvojë punë menaxheriale që është kërkuar në ligjin aktual e mendojmë që duhet të jetë në qoftë se duhet të ketë ndryshim duhet të rritet përvoja e punës e jo të hiqet tërësisht nga kjo. Po ashtu ka qenë edhe parimi i shmangies së konfliktit të interesit. Ligji aktual e thotë që ai nuk duhet të jetë i angazhuar qoftë si punëtorë apo konsulent diku tjetër, kjo është heq mendojmë që duhet të vazhdoj të jetë.

Në pjesën e tretë të projektligjit tek neni 48 konsiderojmë që “individët që ushtrojnë profesione të rregulluara sipas ligjit 05/L-66 për profesione të rregulluara, konsiderojmë që këta individ duhet të konsiderojnë biznese individuale. Është standard i disa ligjeve të tjera, mendojmë që duhet të futet edhe këtu, .. çka se ndoshta në praktikë gjithsesi ata do të konsiderohen biznese individuale.

Një tjetër element që mendojmë që komisioni duhet t'i kushtoj vëmendje janë afatet kohore sidomos te pjesa e udhëzimeve administrative, për shembull tek neni 19, jepet gjashtë muaj kohë për hartimin e udhëzimit administrativ për numrin unik identifikues.

Mandej te neni 268, tek nxjerrja e akteve nënligjore jepet ministrisë afat një vjet për nxjerrjen e akteve nënligjore.

Po ashtu tek neni 266, i jepet afat shoqërive tregtare që të obligohen që të zbatojnë kërkesat e këtij ligjit brenda tre viteve.

Ne konsiderojmë që kjo periudhë është shumë e gjatë sepse të gjitha këto ndryshime që edhe ne i shohim shumë pozitive si regjistrim elektronik, si raportimi, si publikimi i regjistrimit elektronik janë shumë pozitive edhe në kuptim të hulumtimit të tregut për biznese të tjera dhe lënia e një hapësire prej tre vitesh që ARBK-ja dhe autoritetet tjera të kontaktojnë shoqëritë ekzistuese tregtare dhe të bëjnë regjistrimin e tyre elektronik, mendojmë që është periudhë shumë e gjatë, është e kuptueshme që ministria të kërkoj periudha dhe t'i kërkoj t'i lejë vetes sa më shumë hapësirë kohore për realizimin e akteve nënligjore dhe obligimeve të tjera, por mendojmë që Komisioni ka obligimin që të shoh më detajshëm në kuptim të interesit publik se a duhet përshpejtuar këto procedura apo jo, e ne konsiderojmë që ka hapësirë që kjo të bëhet.

Në përgjithësi përveç pjesës që e konsiderojmë që duhet të trajtohet ngadalë dhe mirë e jo të ngutet vetëm për të zënë hapin me .. biznes.

Mendojmë që ligji ka sjell disa risi jashtëzakonisht të mirë siç është regjistri elektronik, raportimi, një përgjegjësi më e sqaruar e komunave e të tjerë që janë përfshirë ... pozitive që ne i shohim në këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Abazi! Vazhdojmë diskutime të tjera. Zoti Ilaz Ramajli.

ILAZ RAMAJLI: Zoti kryetar,

Pjesëmarrës,

Përfaqësues të Ministrisë Tregtisë dhe Industrisë,

Unë jam njëri prej atyre që më është dhënë shansa qysh në fillim të punës në ligj të marrë pjesë dhe të kontribuoj por nuk kam pasur mundësi.

Prandaj, edhe në këtë fazë personalisht por edhe të tjerët nuk mendoj që duhet të hapim çështje të cilat do të na kthejnë në fillim, por të ju përmbahemi dispozitave të propozuara të ligjit dhe të provojmë që t'i përmirësojmë ato.

Nga ky .. unë përveç disa çështjeve thelbësore që mendoj që duhet edhe një herë të rishqyrtohen, kamë bërë edhe vërejtje të natyrës teknike dhe vërejtje tjera, ka gabime teknike për shembull te pjesa për shoqëritë, për SHPK-në termi Bord i drejtorëve shpesh në këtë pjesë zëvendësohet me termin bord menaxhues ajo duhet të unifkohet dhe shumë të tjera të cilat do t'ia dorëzoj personave të autorizuar që t'i shohin vërejtjet e vogla t'i quaj ashtu.

Por unë mendoj që duhet të fokusohemi në këtë dreftligj në disa çështje thelbësore.

E para, është çështja që e përmendi edhe parafolësi, kapitulli të objektivi ku përmendet direktivat e Bashkimit Evropian.

Formulimi që ky ligj është pjesërisht në përputhje është shumë jo i kjashtë, duke marrë parasysh se në rast të një kontesti gjyqësorë palët mund të thirren në tërësinë e direktivës EU-së cilado që është përmend. Nga vendet e regjionit që kanë hy në Bashkimin Evropian domethënë Sllovenia dhe Kroacia, Sllovenia e ka këtë kapitull por e ka definua që i bartë në tërësi direktivat e cekura ka më tepër se sa që janë cek në ligjin këtu në ligj. Ndërkaq Kroacia nuk ka një formulim të tillë por i ka inkorporua nenet e ligjit të gjitha kërkesat e detyrueshme të këtyre direktivave.

Unë them që këtë duhet ose ta definojmë mirë ose ta heqim fare për shkak se shumë prej dispozitave që janë në këto direktiva i përmban drafti i ligjit që e kemi këtu. Një çështje që nuk është përpunua këtu dhe që e kanë dy legjislacionet të këtyre dy vendeve të regjionit që kanë hy në Bashkimin Evropian është përdorimi si emër i bizneseve, përdorimi i emrit të Kosovës, të komunave të Kosovës, shenjave, stemave dhe emrave personal qofshin ato emrat e personave historik apo edhe aktual.

Do të thotë këto dy ligje të dyjat e kanë rregullua mirë që përdorimi i emrit të shtetit, stemës, shenjave, emrit të komunës dhe emrave personal duhet të shkoj sipas një procedure e cila përcaktohet me ligj që për përdorimin e emrit shenjave dhe stemës së shtetit duhet të jep pëlqim Qeveria dhe për përdorimin e emrit, stemës dhe shenjave të komunës komuna. Unë i kam bartë këtu direkt propozimin tim si neni 6 a, formulimet që janë në Kroaci dhe në Slloveni që janë plotësisht identike.

Çështje tjetër e cila duhet shpjegohet mirë për shkak se në praktikë ka me krijuar konfuzion të madhe është instituti që përcaktohet me nenin 25 për personin kompetent për pranimin e dokumenteve. Nga gjuha e përdorur në ligj nënkuptohet që ky person duhet të regjistrohet në regjistër të biznesit dhe të jetë i publikuar emri i tij.

Në ligjin e vjetër dhe në Rregulloren e UNMIK-ut për shoqëri tregtare përafërsisht detyrat që janë dhënë këtu kanë qenë të përfshira në institutin e agjentit të regjistruar. Në qoftë se fjala është për një person të tillë atëherë formulimi qysh është thënë këtu ose për kapacitet ligjor personi i tillë atëherë formulimi qysh është dhënë këtu duhet definohet se nuk mund na me shkua në regjistër me regjistrua, personi kompetent për pranimin e dokumenteve, nuk është formulim ligjor do të thotë i mirë dhe i kuptueshëm veçanërisht për investitorë të huaj.

Prandaj, neni 25 personi kompetent për pranimin e dokumenteve duhet të saktësohet kjashtë.

Këtë institut ligjor nuk e kanë dy ligjet e vendeve në regjion që i përmenda që janë pranua në Bashkimin Evropian, ata e njohin kryerjen e aktiviteteve ekonomike në një vend jashtë selisë që nuk e ka definicionin e degës por nuk e njohin personin i cili mund të pranon dokumente ashtu siç është thënë ky në emër të një shoqërie tregtare. Prandaj, unë besoj që në këtë fazë duhet të sqarojmë qartë për çka bëhet fjalë edhe cilat janë autorizimet dhe qysh do të regjistrohet në regjistër.

Një çështje tjetër është te natyra e regjistrimit. Deri më tani në Rregulloren për shoqërinë tregtare të UNMIK-ut dhe në ligjin që është në fuqi, natyra e regjistrimit në Kosovë ka qenë e natyrës administrative, formulimi është dhënë saktë në ligjin e tashëm dhe ka bërë dallim të saktë dhe për palët e treta ka qenë e saktë, ka qenë lehtë e identifikueshme se nuk bëhet fjalë për regjistrim konstituiv i cili bëhet në gjykatë, i cili auditohet para se të regjistrohet në gjykatë dhe për të dhënat dhe ajo që është regjistruar përgjigjet regjistri. Te ne kemi natyrën e regjistrimit administrativ ku përgjegjësinë e mbartin ata që aplikojnë për regjistrim, regjistri i vetëm gjë që kontrollon është a përputhen aktet e dorëzuara me kërkesat minimale të ligjit, ndërkaq për vërtetësinë e dokumenteve, nënshkrimeve në të dhe autorizimet që i kanë persona në këto përgjigjet ai që ka nënshkruar dokumentet dhe ka dorëzua në regjistër.

Prandaj, unë them që në nenin 20 e kam fut këtu, këtu të transportohet komplet një pikë e veçantë ku e shpjegon natyrën e regjistrimit se kjo i heq të gjitha dilemat për palë të treta se për çka bëhet fjalë në qoftë se e sheh dokumentin e regjistruar në WEB faqen e ARBK-së.

Çështje tjetër është neni 24.6, është një formulim shumë i çuditshëm ku thuhet shoqëria tregtare mund të autorizoj një person tjetër përpos përfaqësuesit të autorizuar, të përcaktuar nga paragrafi 3 i këtij neni për të përfaqësua shoqërinë tregtare. Çka është ky nuk është thanë. Ligjet, të përcjell gjuhën e përdorur këtu, fitohet përshtypja që është provua të transplantohet në këtë ligj një institut që është i njohur edhe në Ligjin e Kroacisë edhe të Sllovenisë që quhet përfaqësuesi me prokura apo prokurisë siç e quajnë ata.

Propozimi im është që ky nen ose të shlyhet krejt se krijon huti dhe është pasiguri juridike për pal të treta ose saktësisht të emërtohet çka është ky dhe a regjistrohet, a është detyrim ligjor për regjistrimin e tij dhe për përshkrimin e autorizimeve të tij, cila do të publikohen në regjistrin në faqen e ARBK-së. Po propozimi im me qenë se, duke e lexuar disa herë kontestin e krejt ligjit dhe këtë pikë të nenit 24 unë them që ky duhet të shlyhet tërësisht.

Një çështje që edhe në ligjin aktual ka qenë shumë diskutabile është çështje e kapitalit themeltar te shoqëria me përgjegjësi të kufizuar. Në draftin e ligjit aktual ka qenë e përcaktuar kapitali themeltar. Në Komision të Kuvendit nga njohurit që kam unë është heq kapitali themeltarë me insistim të ministrit. Mirëpo unë edhe atëherë edhe tash konsideroj se është gabim. SHPK-ja është thënë mirë tash që banë pjesë te korporatat dhe janë persona juridik një.

Kapitali themeltar te dy korporatat shprehet përmes aksioneve. Aksionet shërbejnë, vlera nominale e tyre për të tregua kapacitetin e vendimmarrjes një aksionari dhe marrjen e dividendës në rast se shpërndahet në bazë të numrit të aksioneve me vlerë nominale që ai e ka. Korporatat janë edhe shoqëri të kapitalit, domethënë në teorinë ekonomike dihet që janë shoqëritë kapitale.

Nuk mund t'i imagjinoj që një SHPK nuk ka kapital themeltarë i cili shërben menjëherë pas themelimit dhe regjistrimit të saj për t'i rregullua mënyrën e vendosjes të aksionarëve. Për shembull Kroacia, Sllovenia, Mali i Zi, Shqipëria suksesivisht gjatë kalimit të kohës dhe nga kërkesat e biznesit kanë zvogëluar kapitalin fillestar themeltarë të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar por asnjëra prej tyre nuk e ka më të vogël se 500 euro, Kroacia e ka 500 euro, Sllovenia e ka 500 euro, Mali i Zi e ka 500 euro, Shqipëria më duke 1000 euro sa e di unë.

Prandaj, unë kam propozua dhe e kam fut këtu te neni 85 kontributet shkohet, kapitali themeltar dhe kontributet dhe neni 85 të jetë kapitali themeltar, ndërkaq kontributet siç vazhdon mënyra e dakordimit dhe të pagesës kapitali.

Neni 111, një çështje tjetër. Instituti i personit ngarkuar me detyrë, domethënë është dhënë një formulim që mua nuk më vjen keq të them që nuk e kuptoj fare dhe nuk e di pse është edhe si është transportua këtu, cila është arsyeshmëria. Po e lexoj, të gjithë personat e tjerë që ushtrojnë disa nga kompetencat e drejtorëve menaxhues dhe të tillë nuk ka me ligj dhe me statut se atje saktësisht caktohet, kanë përgjegjësinë e tjera e tjera.

Kam kontrollua krejt ligjet e vendeve në regjion edhe dy ligjet që kanë hy në Bashkim Evropian nuk kanë një formulim të tillë. Ligji Kroat e ka i vetmi një nen që thotë përfaqësuesi në bazë të punësimit, përfaqësuesi në bazë të punësimit dhe ka dhënë definicionin, i punësuari i cili kryen autorizime në bazë të vendit të punës që ka ai ka të drejtë me nënshkrua kontrata e tjera e tjera për aq sa janë dhënë autorizime me aktin e brendshëm apo me një autorizim të veçantë të personit të autorizuar drejtorit në këtë rast.

Prandaj, unë them ose të merret ky formulim i Kroacisë ose të shlyhet krejt kjo që është thanë këtu. Edhe një vërejtje të përgjithshme e kam, domethënë këto ishin konkrete që i thash.

Sa i përket akteve nënligjore dhe autorizimeve që janë dhënë drejtorit qofshin ... aktet nënligjore, që i nxjerr ministri apo aktet nënligjore, që i nxjerr Qeveria, të përmendura këtu, saktësisht duhet të thuhet që asnjë akt ligjor apo vendim i drejtorit nuk guxon t'i tejkalojë detyrimet që janë dhënë në ligj lidhur... Këtë po e them nga praktika. Sot, hyni në faqen e ARBK-së dhe e shihni që jashtë detyrimeve ligjore, atyre që aplikojnë për regjistrim të biznesit, ose për ndryshim të biznesit, janë shtuar kërkesa shtesë që janë të kundërligjshme dhe po të hapej një proces gjyqësor...

Për t'i ikur kësaj arbitraritetit të drejtorit të ARBK-së apo të ministrit a Qeverisë, që të shkojë përtej dispozitave ligjore, në çdo nen të ligjit ku përmenden këto duhet me e fut formulimin, që këto akte nuk guxojnë të tejkalojnë dispozitat e këtij ligji. Unë i kam dhënë këto konkretisht.

Ajo që i frikëson më së shumti investitorët e huaj, këtë po e them nga përvoja ime personale, është që me akte nënligjore në Kosovë futen institute dhe dispozita tjera, që fare nuk janë të parapara me ligj dhe kjo në teorinë juridike quhet arbitraritet i institucioneve dhe zyrtarëve në raport me ligjin. Unë ju falënderoj.

KRYETARI: Faleminderit shumë, Ilaz!

Unë mendoj që ishin disa vërejtje shumë të rëndësishme. Të them të drejtën, edhe ne duhet një çështje që ti e ngrite... çështja e... atë që e thatë ju, kush e bën përgjegjësinë për saktësinë e dokumentacionit që prezantohet, natyrën e regjistrimit. Kjo çështje është mjaft e rëndësishme.

Unë mendoj që ne e kemi diskutuar edhe në komision, prandaj duhet, sado që ne duhet të jemi në favor të thjeshtësimit, të ikjes së çështjeve burokratike, po ashtu nuk mund ta lëmë që neve në regjistrim të na futen edhe persona fiktivë.

Ndërhyrje..... Në qoftë se bën me ndërhy. Në qoftë se, koncepti ndryshon për natyrën e regjistrimit, të jemi të sigurt se duhet diku sa i përket kapitujve për regjistrim të shoqërive tregtare duhet të ndryshohet diku 70%.

Duhet të futen, se kryesisht regjistrimi konstituiv, ku është bërë nëpër gjykata, edhe tash bëhet nëpër gjykata. Ata që kanë aplikuar regjistrimin jashtë gjykatave, përmes agjencive, regjistrim biznesi, e tjera... ky është një trend, tash ka filluar prej Polonisë dhe gjithandej është, Sllovenia ka kaluar në këtë formë. Është regjistrim administrativ, se me u futë në regjistrim, natyra e regjistrimit me qenë konstituiv, këtu duhet me fut deri edhe auditorin e regjistrimit. Domethënë, një auditor i pavarur i caktuar prej ARBK-së, i cili e konfirmon që çdo gjë është e vërtetuar.

Po, kjo ka qenë shumë, është vlerësuar prej të gjithëve, edhe shtrënguese, edhe burokratike dhe ka gjeneruar elemente të korrupsionit shumë. E keni në raportin e Bankës Botërore, që nuk ka ndonjë vlerësim pozitiv për atë mënyrë të regjistrimit.

FLUTURA SHALA: Përshëndetje!

Flutura Shala, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike.

Fillimisht, dëshiroj të theksoj faktin se ne si MZHE nuk kemi qenë pjesë e hartimit të këtij projektligji, as nuk kemi qenë pjesë e konsultimeve paraprake, procedurë kjo e cila është udhëhequr nga MTI. Andaj, draftin e këtij ligji e kemi marrë javën e kaluar, më rastin e marrjes së ftesës nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, për dëgjim publik.

Meqenëse, ka qenë një kohë shumë e shkurtë dhe duke e ditur faktin, se ky projektligj ka një përmbajtje voluminoze, ne po paraqesim një vështrim të përgjithshëm, në mënyrë që në ditët në vijim të japim komentet tona në nenet e këtij ligji në mënyrë të detajuar.

Komentet tona kanë të bëjnë kryesisht me pjesën e shoqërive aksionare, meqenëse me Ligjin për ndërmarrje publike të gjitha ndërmarrjet, si ato qendrore edhe lokale, kategorizohen si shoqëri aksionare. Komentet tona fokusohen për aq kohë të shkurtë që e kemi pasur, tek themelimi i një ndërmarrjeje të re publike, pastaj kemi tek shpërndarje e dividendës, tek bordi i drejtorëve dhe te zyrtarët. Kemi theksim te zgjedhja dhe mandati i drejtorëve, pastaj te shkarkimi i drejtorit, është fjala për drejtorin menaxhues, është e cekur që mund të shkarkohet me ose pa arsye e që sipas nesh është mjaft diskriminuese.

Duke u nisur nga ato që i ceka më lartë, ne si MZHE kërkojmë një afat kohorë shtesë, që këto komente t'i dërgojmë me shkrim.

KRYETARI: Në fund do të lusim të gjithë për një afat, por meqenëse tash e ceke, ju lus që deri të hënë t'i kemi me shkrim, për arsye se kemi një kërkesë prej Ministrisë, që ligji të aprovohet deri më 11 maj. Është me rëndësi, tash procedurat duhet të shkojnë brenda kësaj jave, presim amendamentet pastaj, duhet të punojë komisioni, pastaj të aprovojë komisioni amendamentet, të shkojnë amendamentet në të gjitha komisionet e përhershme të Kuvendit, të kthehen përsëri në komision tek ne edhe të shkohet në lexim të dytë në Kuvend.

Krejt këto operacione duhet të kryhen, nja dhjetë ditë para 11 majit. Kështu që, kërkojmë falje por deri të hënën duhet të na i dërgoni me shkrim çka keni, për arsye se javën që vjen ne duhet të punojmë dhe t'i përfundojmë amendamentet, javën tjetër.

E ka fjalën zoti Ibrahimaga, Virtyt Ibrahimaga.

VIRTYT IBRAHIMAGA: Jam Virtyt Ibrahimaga, avokat.

Unë merrem me çështje komerciale dhe jam në praktikë, çdo ditë merrem me problemet të cilat ndërliken me Ligjin për shoqëritë tregtare.

Më lejoni, që ta bëj një koment të përgjithshëm sa i përket metodologjisë. Unë e kuptoj që ligj është tash shumë i avancuar dhe nuk ka dëshirë askush për t'u kthyer prapa, mirëpo në të ardhmen do të ishte mirë, që pjesën administrative të ligjit, sa i përket organizimit të regjistrimit publik, me e nda me ligj të veçantë se kjo është e drejtë administrative. Kurse, çështjet e organizimit, themelimit të shoqërive tregtare, kjo është e drejtë private. Dhe kjo duhet, nga aspekti metodologjik, të rregullohet me ligj të veçantë. Kjo nuk është zbuluar këtu, kjo është gjithkund ashtu dhe besoj që edhe ne duhet të kalojmë në atë drejtim.

Kjo e ka edhe një arsye tjetër, se për shembull, në këtë ligj unë po shoh ka shumë ndryshime edhe pse, përparimin sa i përket organizimit të brendshëm të Agjencisë për regjistrimin e bizneseve, po sikur ta kishim një ligj të veçantë ndoshta nuk ish dashur me e ndryshua krejt ligjin e me bë edhe më të madh, po e kishim rritur, e kishim ndryshuar vetëm atë dhe këtë pjesën tjetër, e kishim... sa i përket organizimit, themelimit të shoqërive tregtare, e kishim ndryshuar kur të na duhet e jo gjithmonë sa herë kërkohet ndonjë reformë administrative e një organi administrativ.

Sikurse thash, sa i përket organizimit, ka risi. Për tu përshëndetur janë detaje nganjëherë, se çfarë përgatitjeje profesionale duhet me pas, krejt në rregull, ato janë çështje që mund të diskutohen. Pjesa tjetër materiale nuk është prekur shumë, fatkeqësisht. Mbesin probleme për klimën e biznesit, për investimet e jashtme, mbesin pa u zgjidhur. Tash, ne e kemi shumicën e shoqërive tregtare të regjistruar sikurse shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe duhet të bëhet reformimi i këtyre dispozitave, që kanë të bëjnë me organizimin e këtyre shoqërive. Ka edhe biznese individuale shumë, kolegu më korrigjoi, ashtu është, edhe ajo çështje duhet të adresohet. Për shembull, për ndër problemet kryesore është kalimi prej biznesit individual në SHPK, se në një kohë shumë biznese fillojnë të zhvillohen dhe kanë nevojë për të kaluar.

Në praktikë kjo ka sjellë probleme shumë të mëdha. Për shembull, ATK-ja vetëm për shkak të një numri, të cilin s'ka mundur ta gjenerojë, nuk ka lejuar transformimin e biznesit prej biznesit individual në SHPK. Do të thotë, kjo ndoshta për mentalitetin tonë është diçka e kapshme, se e kuptojmë, mirëpo për dikë që vjen nga jashtë... thotë, nuk mund ta kuptoj unë pse një numër mund të jetë pengesë që unë ta bëj transformimin e një shoqërie.

Mandej, edhe kolegu Ramajli e përmendi kapitali themeltar. Shikoni, investitorët e jashtëm, ose tregtarët e kompanitë që tregtojnë me Kosovën, e kanë shumë me rëndësi sigurinë juridike dhe duan të dinë se me kë po hyjnë në biznes. Momentalisht, nëse një LLC, një SHPK, nuk ka kapital themeltar, atëherë do të thotë se ai person nuk di se kush do të jetë përgjegjës për borxhin që do të krijohet, se nuk ka ku me i marrë ato mjete. Edhe, çfarë ndodhë në praktikë? Ndodhë në

praktikë, që kërkohen garanci bankare, kërkohen hipoteka, për të siguruar mallin i cili importohet në Kosovë, kërkohen garanci të reja të cilat gjenerojnë shpenzime shtesë pastaj për biznesin e Kosovës dhe automatikisht rritet pastaj edhe kostoja e atij malli, ose asaj lëndë të parë, ose asaj makinerie, e cila duhet të vijë këtu edhe duhet të shitet në Kosovë. kjo në mënyrë indirekte i kontribuon ngufatjes së biznesit, pamundësisë që biznesi të financojë një lëndë të parë, ose një mall të cilin importon dhe rritjen e kostos së prodhimit, gjë që mandej reflekton që një biznes i Kosovës, që do të prodhojë, ose që të...thjesht nuk është konkurrent me çmimin të cilin ofron.

Pra, kapitali themeltar nuk është çështje që e kemi zbuluar ne, kjo është çështje botërore, botërisht e njohur, pavarësisht prej asaj nëse ministria dëshiron me hip atje në vend me këto raportin e Bankës Botërore, unë mendoj që siguria e qarkullimit të mjeteve në Kosovë është shumë më me rëndësi, edhe investimet e huaja, se sa një rankim teknik, se ai thjesht nuk çon ndonjë peshë, se njerëzit të cilët duan të investojnë këtu, nuk shkojnë të orientohen në bazë të raportit të Bankës Botërore, por këta interesohen te ambasada e vet, ata interesohen te odat ekonomike edhe aty e marrin këshillimin, që duhet të sigurohet, se nesër pasnesër ti nuk ke siguri që mund t'i inkasosh ato mjete, të cilat të ka mbetur borxh ai.

Sa i përket harmonizimit të direktivave të BE-së, unë ju kisha lutur me i largua të gjitha, se as për së afërmi kjo nuk i përmbush këto çka... nuk i harmonizon dispozitat e këtij ligji me të BE-së dhe nuk është me rëndësi, unë nuk jam për atë që ne me shkua tash në harmonizim të plotë, mirëpo nuk kemi nevojë të bëjmë referenca tash direktiva të BE-së, pa kurrfarë nevoje dhe me të vërtet, pa e përcaktuar qartë se cila prej këtyre direktivave ka qenë prioritet tash për ne për të implementuar tash këtë ligj, nëse ka atëherë le të identifikohen dhe me të vërtet le të bëhet harmonizimi.

Sa i përket aksionit, tash ne e kemi këtu një çështje, ka dy variante të cilat përdoren tek shoqëria me përgjegjësi të kufizuara, aksione ose kuota. Për shembull, këta në Shqipëri e kanë kuota, këta pjesa kontinentale i quan kuota dikush më modern i ka shndërruar në aksione. Mirëpo, një send është me rëndësi, nëse ne përcaktohem që një SHPK duhet të ketë aksione, atëherë aj aksion duhet me qenë diçka, duhet me qenë e identifikueshme, se duhesh me e emituar atë aksion, nuk është veç me shkrua "unë i kam 100 aksione", se nesër pasnesër unë dua të ekzekutoj mbi aksionin tënd edhe s'mund ta ekzekutoj, se s'ka identifikim, nuk ka vlerë, nuk dihet... nuk e ka emrin se kush është i regjistruar pronar. Pra, në qoftë se veç kalojmë te koncepti i aksioneve, atëherë ato duhen me u identifikua, ose me regjistër, ose me certifikatë dhe ajo duhet me qenë e detyrueshme, jo opsionale, se qysh e përcakton ligji. Ligji tash për shembull, e përcakton edhe dy akte themelore, është memorandum i prokurimit dhe statuti. Edhe në ligjin e kaluar e kemi pasur këtë problem.

Duhet me e bë një ndryshim, se përndryshe këto dy akte janë vetëm deklaruese. Duhet me e bë një ndryshim, se cili akt çka rregullon. Në gjithë Botën është një akt, quaje si të duash, ka emra të shumtë. Është një akt, i cili është letërnjoftimi i kompanisë, aty shkruhet emri i drejtorit, adresa, numri i aksioneve, identifikimi i aksionarëve, kapitali themeltar...

Akti themelues i përmban të gjitha këto, akti tjetër duhet me i rregullua marrëdhëniet në mes aksionarëve, do të thotë sa i përket organizimit, ndarjes së dividendës, thirrjes së mbledhjes, ndarjes... në rast se donë me u nda aksionarët, trashëgimit, e tjera sende të tjera. dhe këto duhet

me u përcaktua shumë qartë, se cili akt çka rregullon, se për momentin këto e kanë përmbajtjen e rregullimit të njëjtë, qysh është e përcaktuar: ... organizimi kooperativ, unë nuk po e shoh që ka ndonjë përparim. Në praktikë kemi probleme të mëdha me mbajtje të mbledhjeve të aksionarëve, me votimin, me vendimet e shkruara, me formën e thirrjes së mbledhjes së aksionarëve, mënyrën e votimit, unë nuk po shoh që këto janë sende të rregulluara qartë.

Ne e kemi një nen që thotë, nëse nuk është përcaktuar ndryshe në statut... ose, nëse qaj ndryshim nuk kërkon ndryshimin e statutit, atëherë duhet me shumicë të thjeshtë, ndoshta s' ishte keq me u rregullua se çka nënkupton ajo "shumicë e thjeshtë", ajo në terminologji juridike nënkuptohet, mirëpo për ta evituar secilin dyshim është mirë... po, mandej nëse kërkohet vendim unanim për ndryshimin e të gjitha informatave me statut, ajo ndoshta edhe është mirë, mirëpo ta mendojmë mirë se çka do me thënë, se në statut shkruan edhe adresa, në statut shkruan edhe ndërrimi i veprimtarisë, në statut shkruan edhe ndërrimi i drejtorit, do të thotë nëse kërkohet mendim unanim për ndryshim të të dhënave, ndryshim të statutit, atëherë duhet me qenë vendim unanim, mirëpo duhet shikuar a është ajo e drejtë apo me e vu, sikurse e kanë disa shtete të tjera, e kanë me 2/3-at, ose shumica 50 thjesht me 50%, por kjo duhet të sqarohet, që mos me pas probleme, se pastaj lindin problemet, lindin konflikte juridike.

Ne kemi shumë ngarkesë në gjykata, sa u përket kontesteve në mes aksionarëve, që s'po mund të zgjidhen. Ligji, për shembull, e përcakton se edhe pas shitjes së aksioneve, edhe në qoftë se të drejtën e parablerjes për shembull në SHPK nuk është e përcaktuar si duhet. Në rregull, veç nëse përcaktohet me statut. Disa shtete ia ofrojnë aksionarit tjetër, pavarësisht e shkruan në statut apo jo. unë nuk e di a është menduar kjo, mirëpo në qoftë se i jepet e drejta për t'u shitur aksionet një bashkëaksionari të një personi i tretë pa të drejtë të parablerjes së aksionarit tjetër, atëherë nuk e di pse duhet një nen tjetër, neni 45, ku thotë, për të hyrë ai aksionari i ri tash në këtë shoqëri duhet vendim unanim. Tash, unë e kam kontest shumë real lidhur me këtë çështje. nuk po flas për një send teorik, por është shumë praktik. Po flas, në gjykatë qe disa vite, qe katër vite, ku janë shitur aksionet dhe aksionarët tjerë nuk e pranojnë aksionarin e ri, edhe pse që nuk i kanë blerë aksionet.

Mandej, e kemi... mungon dispozita për ndalimin e konkurrencës. Kjo ka probleme në Kosovë shumë. nëse, dy tre persona bashkohen në një shoqëri të përbashkët për të ushtruar një veprimtari edhe pastaj një person tjetër shkon regjistron një kompani tjetër dhe i bën konkurrencë kompanisë të cilën e ka bërë bashkërisht me të tjerët, kjo është një praktikë që nuk tolerohet askund edhe këtu duhet me u sanksionua. Do të thotë, nuk ka nen për ndalim të konkurrencës jolojale, konkurrencës me veprimtarinë e njëjtë...

Ndërhyrje...

VIRTYT IBRAHIMAGA: Po, drejtori është i punësuar ai s'mund të shkojë me... i njëjti nuk bën, se ... Kufizime në shpërndarje nuk ka. Çka ndodhë? për shembull, ekziston një kompani, ka shumë borxhe, ata e bëjnë shpërndarjen edhe pse kanë shumë borxhe. Ajo nuk... atëherë mbetet kompania pa mjete financiare për të paguar.

Shumë kompani në Kosovë nuk janë Unë nuk e di se sa të mirën po ua bëjmë ne këtyre kompanive, që i lejojmë të operojnë edhe pse s'kanë mjete. Ato hyjnë në përgjegjësi, hyjnë në

detyrime me palë në mënyrë të pakufishme edhe pse nuk janë në gjendje të paguajnë. Kjo duhet me u rregullua, duhen me dalë jashtë, se përndryshe kemi probleme të mëdha.

Raportet që shkojnë nga jashtë për Kosovë, për biznese në Kosovë, janë shumë negative, sa i përket aftësisë për të paguar, edhe nuk kemi rregull. Pra, duhet me e përcaktua detyrimet e drejtorit, detyrimet fiduciare të drejtorit, i cili në momentin kur kompania që ai drejton nuk është më sorbente, me paraqitë menjëherë kërkesën për të hy në procedura të falimentimit të detyrueshëm.

Unë nuk e kam pa, mund të ndodhë... as Ligji për falimentim nuk e ka këtë dispozitë, për çudi. Jo, nuk ka, se unë ... po me kërkesë të tjetërkujt, me kërkesë të kreditorit, ose prej debitorit.

Ndërhyrje.....: debitorit dhe kreditorit, po është në vullnet të tyre, nuk është detyrim ligjor.

VIRTYT IBRAHIMAGA: qajo, nuk është detyrim i debitorit vet me shkua me thënë, unë nuk mundem më të paguaj. Po, ajo është elementare, se në qoftë se nuk e detyron, ai do të vazhdojë të operojë edhe ka me bë dëme të tjera, ka me hy në detyrime të tjera pa kufi edhe s'ka me mund me i kthi. Ne plot gjyqet i kemi me lëndë të tilla.

E kemi problemin tjetër, që shumë kompani janë pasive, edhe pse janë të regjistruara. Ne në këtë ligj, unë propozoj që me hy megjithatë detyrimi i raportimit vjetor pranë agjencisë ARBK-së, që secila kompani të dorëzojë një raport vjetor edhe nga ajo me u përcaktua nëse ajo kompani me të vërtet ekziston, ose kompanitë për shkaqe të ndryshme, ndonjëra nuk ka sukses dhe një tjetër ka probleme me aksionarë, probleme të brendshme domethënë nuk ec përpara, mirëpo të gjitha ato figurojnë dhe të gjitha ato janë të afta me hy në marrëdhënie kontraktuese, qoftë me partnerë vendorë, qoftë me partnerë ndërkombëtarë. Kemi shumë raste të mashtrimit me investitorë të huaj, të cilat gjithashtu dëmtojnë reputacionin e Kosovës.

Kolegu e përmendi agjentin e regjistruar, unë mendoj që agjenti i regjistruar duhet të mbetet terminologjia sikurse ka qenë. në praktikë ne kemi shumë probleme, që nuk e gjejmë, thjesht unë e padis një kompani, nuk e gjej, ajo është fantome dhe natyrisht se duhet pasur mundësi që një padi, e cila është parashtruar në gjykatë diku me u dorëzua, se përndryshe ti s'po ke as ku me e dorëzua.

Kështu që agjenti i regjistruar duhet të mbesë dhe duhet t'i përcaktohen detyrimet që i ka.

Te kushtet formale, edhe një herë po them, të SHPK-së, për thirrjen e Kuvendit duhet me u përcaktua në mënyrë më të qartë, se sa duhet afati, qysh duhet të dorëzohet ftesa për Kuvend, sa kanë kohë dhe të drejtë aksionarët tjerë për të propozuar ndryshime në mbledhjen e Kuvendit të aksionarëve, a kanë të drejtë aksionarët, për shembull, thjeshtë të përfaqësohen në atë kuvend, do të thotë janë çështje formale, të cilat rregullojnë dhe parandalojnë konfliktet në mes aksionarëve, në qoftë se përcaktohen si duhet.

Te shoqëria aksionare, ne kemi një numër shumë të vogël të shoqërive aksionare dhe ndoshta është mirë me u shikua pse e kemi atë numër të vogël. Ka shumë arsye. ndoshta, është mirë kjo çështje të trajtohet, po nuk e di sa mundet, tash komisioni me e trajtua këtë. Kryesisht, në

perëndim ndahen në ato që janë të hapura dhe në ato që janë të mbyllura. Ato që janë të hapura, ato zhvillohen më shumë, se ato emetojnë pastaj letra me vlerë, të cilat janë të qarkullueshme edhe kanë qasje më të lirë në kapital. Do të thotë, përmes shitjes së aksioneve andaj edhe vjen deri te kapitali investues i një kompanie, përmes qarkullimit të lirë të letrave me vlerë, pastaj promovohet edhe themelimi i berzës, do të thotë janë mundësi, duhet shikuar mundësinë se si me e promovua zhvillimin e shoqërive aksionare, dhe atë e bëjmë në qoftë se ulemi dhe themi: pse ka kaq pak edhe pse s'po mund të shtohen?

Këto janë të përgjithshme, të tjerat ua dërgojmë me e-mail. Faleminderit!

ILIR GAXHA:

Jam Ilir Gaxha, jam nënkryetar i Komitetit Ligjor të Shoqatës së Bankave, njëkohësisht punoj në Bankën TEB, në departament ligjor.

Edhe neve, sikur ministria që shpjegoi, nuk na është dhënë mundësia për të qenë pjesëmarrës në grup punues. Mendojmë që do të kontribuonim shumë si komunitet i Ballkanit. Asnjë nga bizneset nuk mund të operojë pa pasur llogari bankare dhe kanë produkte të cilat i kanë ekspozuar, kështu që sigurimi i dokumentacionit në rregull para bankave ka qenë thelbësor.

Në bazë të përvojës tonë kemi pa shumë parregullsi, për të cilat na jemi detyruar për të insistuar prej klientëve me i sigurua, derisa të njëjtat kanë rezistuar për t'i sigurua, se të njëjtat ia kemi dhënë shtetit, nëse ata na kanë licencuar, çka keni ju me u marrë me këtë punë?

Siç e përmendi edhe zoti Ramajli, është fakt evident shqetësimi lidhur me besueshmërinë e dokumenteve të regjistrimit, për shkak se regjistrimi është bërë vetëm procedurë administrative, nuk merr askush përgjegjësinë për përmbajtjen e dokumenteve. Ne kemi hasur në praktikë, që ka pasur statute që janë dorëzuar të bizneseve të huaja, në gjuhë të huaja, ku ministria nuk ka pasur mundësi as me i shikua, mirëpo vetëm prej formularëve, të cilët i kanë dorëzuar, i kanë përcaktuar se kush janë pronarët, kush e si e menaxhon.

Në praktikë, ne mendojmë që ta lehtësojmë të bërit biznes, ta lehtësojmë regjistrimin e bizneseve, ta lehtësojmë ardhjen e investimeve të huaja, por të njëjtën kohë duhet edhe vërtetimin e dokumenteve ta bëjmë vetëm një herë, në mënyrë që në secilin institucion kur të shkojnë këto biznese me krye punë, mos me pas nevojë secilën herë me e krye verifikimin, sepse atëherë për t'i kënaqur apetitet e secilit institucion, në këtë rast të bankave, palët irritohen dhe është e tepërt.

Në këtë formë, ne çfarë kemi menduar, nëse ministria insiston me e mbajt vetëm rolin e regjistrimit administrativ, si zgjidhje është që dokumentet të noterizohen, të vërtetohen prej noterit para se të dorëzohen aty. Do të thotë, filtri bëhet para se të regjistrohen në ARBK dhe në këtë formë ne eliminojmë pengesën në të ardhmen dhe të gjitha institucionet mund ta kenë regjistrin e RBK-së si regjistër kredibil.

Për këtë arsye, ne dëshirojmë të rezervojmë të drejtën për të dhënë komente, nëse ka mundësi deri të martën, meqë e hëna nuk është ditë pune, dhe shoqata e bankës do të thotë secili

departament ligjor i secilës bankë është duke punuar për të mundur me dhënë komente sa më cilësore për të mundur me i mbulua.

Pak a shumë janë shqetësimet edhe parafolësve edhe tonat, mirëpo meqë kemi një fushë të veprimt të caktuar, ndoshta mund të ndihmojmë më shumë.

Për ARBK-në dhe ATK-në është e lehtë me i vërtetua borxhet që janë ndaj shtetit, mirëpo borxhet që ekzistojnë ndaj të palëve të treta është paksa e pamundur për t'i vërtetuar. Në këtë rast, ARBK-ja kishte me qenë e drejtë ndoshta t'i konsultojë bankat sikur komunitet ose institucione tjera të shikojë se a kanë borxhe këto kompani para se t'i shesin aksionet ose para se t'i bartin te familjarët.

Regjistri i kredive të Kosovës ekziston dhe mirëmbahet në baza ditore në Bankën Qendrore të Kosovës. Nëse ARBK-ja kishte pasur qasje në momentin kur kërkohen të bëhen këto ndryshime, atëherë pse mos të kërkohet edhe pëlqimi i kreditorëve, në këtë rast të bankave, se a lejohet të bartet apo jo.

Ne që e kemi shqetësim parësor, sikur banka, jemi të detyruar me ligje të luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kërkohet ne të bëjmë kujdesin e duhur ndaj klientëve, dhe sikur banka, ne nuk mund të kemi, për shembull, kemi filluar raport kontraktual me një kompani ku edhe përfitues përfundimtarë janë identifikuar, janë verifikuar, kemi krijuar bashkëpunimin, kemi kredituar me produkte, mirëpo tash pa prituri e kujtuar na vijonë e shfaqen aksionarë të ri që banka ndoshta s'është e interesuar të bashkëpunojë. Mendoj se janë nëpër lista ndërkombëtare, lista të zezë, e kështu me radhë dhe në këtë formë ARBK-ja ndoshta do të ishte më mirë të kërkojë këtë pëlqim përmes regjistrimit të kredive të Kosovës dhe të kërkohet banka të jep pëlqim para se të barten aksionet. Tash ndoshta ka edhe institucione tjera ku do t'i kishin t'i vërtetuar se a ka kreditorë tjerë apo jo, por ky është shqetësimi ynë.

Një gjë tjetër, që e përmendën edhe parafolësit, është shumë me rëndësi të identifikohet, nëse domi ta bëjmë regjistrin, ajo formë se kush është përfaqësues i autorizuar, që e dimë edhe forma e autorizimit si bëhet, dhe kush është përfaqësues ligjor i kompanisë. Do të duhej të jenë dy rubrika të veçanta për t'u bërë kategorizimi. Tash, a është nëpunës a jo, a është aksionar e a është drejtor, në bazë të autorizimeve që janë... Ne e dimë se dokumentet themelore, sikur statuti dhe aktet tjera nënligjore të kompanisë i përcaktojnë këto të drejta dhe obligime, mirëpo si të tilla, nëse i nxjerrim dhe fusim në regjistër kishte me qenë shumë më lehtë për të gjitha palët që të shohin kush e çfarë cilësie ka gjatë përfaqësimit.

Personi i autorizuar mund të jetë edhe avokati që ka qenë vetëm sa për ta hapur biznesin, me i krye procedurat e regjistrimit, hapë llogari bankare e kështu me radhë dhe autorizimet do t'i pushojnë në atë kohë, sepse nuk mund të mbetet përjetshëm avokati përfaqësues ligjor për shkak se tjerët janë që do të administrojnë me kompani më vonë dhe këto gjëra do të na ndihmonin në të ardhmen. Një problem që e kemi pasur në të kaluarën, është shndërrimi i bizneseve individuale në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe ka qenë kërkesë edhe e shumë kompanive, dhe e kanë parë që në kohën kur është regjistruar nuk kanë ditur dallimin mirëpo me rritjen e kompanive, shndërrimin në korporata e kanë parë privilegjin që e kanë me përgjegjësi të kufizuar dhe tash – çka ndodhë në rastet kur është lejuar ky shndërrimi, që nuk ka qenë i

paraparë me ligj, kush i merr detyrimet e kompanisë së mëhershme kur ka pronarë krejt tjerë, prej pronarëve të sotëm, po mendoj nëse është shndërruar në SHPK, kështu që jemi të ecim me kohën, për t'i paraprijë ndryshimeve por në të njëjtën kohë edhe mos të humbim kontrollin mbi procesin për shkak se sikur komunitet i biznesit të gjithë mund të dështojmë dhe normal gjykatat janë të stërbushura dhe stërngarkuara dhe ashtu-kështu, nuk pritet zgjidhje e shpejtë, deri sa autorizimet e përditshme mund të shkaktojnë humbje astronomike kompanive e pastaj vetëm këqyrin kë ta gjejnë si përgjegjës.

Këtu ishin ato nënpiikat e shkurtra dhe nuk do ta kishim zgjatur më shumë, e rezervojmë të drejtën vetëm deri të martën nëse mund të japë komente me të vetmin qëllim që të kemi ligjin sa më të kompletuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, ju!

MENTOR MORINA:Faleminderit kryetar!

Përshëndetje deputetë,

Unë jam Mentor Morina, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, pra përfaqësues i ministrive.

Siç e dini, javën e kaluar është aprovuar po ashtu edhe Projektligji për ndërmarrje sociale, të sponsorizuar dhe i draftuar nga Ministria e Punës, pra në të njëjtën ditë edhe kur është aprovuar në Kuvend, kur është aprovuar edhe Ligji për Shoqëritë tregtare, në leximin e parë. Në kuadër të këtij projektligji, meqë ne kemi zhvilluar edhe takime me Ministrinë e Tregtisë më herët që edhe kjo kategori e ndërmarrjeve sociale të përfshihet në kuadër të ligjit mbi shoqëritë tregtare dhe ndoshta s'kemi pasur mundësinë edhe si ministritë tjera të kemi një konsultim më të gjerë, edhe pse jemi pajtuar në vitin e kaluar që kjo kategori të jetë pjesë e këtij projektligji.

Do të sugjeroja që tek neni 5, atje ku ekzistojnë përveç formave tjera, të përfshihet edhe – ndërmarrje sociale, dhe kapitulli 6, që është regjistrimi fillestar i subjekteve tjera, që të hyjë edhe kaloria e ndërmarrjes sociale.

Ndoshta është pak e pakuptueshme për disa pjesëmarrës se nga këto ndërmarrje sociale janë krijuar shumë keqkuptimi se çfarë roli do të kenë. Ndërmarrjet sociale janë pra kategori që do të ofrojnë dhe prodhojnë të mira e shërbime dhe adresojnë çështjet e papunësisë të grupeve të cenuara dhe ofrojnë shërbime të ndryshme sociale.

Pra, janë ndërmarrje sociale të cilat do të gjenerojnë fitim por nuk do të shpërndahet fitimi me kusht që do të integrojnë grupe të caktuara në punësim apo do të ofrojnë shërbime të caktuara sociale, siç janë praktikat e shumë vendeve tjera, prandaj ne do t'i përcjellim këto propozime, por është e domosdoshme që në njëfarë mënyre të jetë pjesë në nenin 5 atje edhe emërtimi i ndërmarrjes sociale si kategori, me që Projektligji ka kaluar në leximin e parë dhe te kapitulli 6 të jetë një nen i ri ku parashihet edhe regjistrimi fillestar i ndërmarrjeve sociale.

KRYETARI: Urdhëroni!

VISAR HAPÇIU: Jam Visar Hapçiu, nga Oda Ekonomike Amerikane.

Ju përshëndes të gjithëve,

Ne si Odë Amerikane i kemi dërguar komentet mbi Projektligj edhe në fazën sa ka qenë në Ministri të Tregtisë dhe Industrisë dhe ngjashëm si kolegët tjerë rezervojmë të drejtën që deri të martën t'i dërgojmë komentet shtesë që i kemi mbi Projektligj.

Meqenëse nuk jam jurist dhe nuk kisha dashur të përsëritem në ato tema që veç u prekën deri tash.

Unë vetëm e kisha dhënë një koment të përgjithshëm se ligji i parasheh disa risi që janë të mira për biznese dhe ambientin afarist dhe kisha dashur të ndalem te mundësia e regjistrimit të zyrave të përfaqësisë, të shoqërive të huaja tregtare, një gjë që deri tash nuk ka qenë e lejuar dhe i ka detyruar shoqëritë e huaja tregtare të regjistrohen si degë, dhe kjo i ka paraqitur disa probleme në praktikë në aspektin e trajtimit tatimor të këtyre degëve.

Pra, meqenëse veç është duke u bërë kjo risi që është patjetër e mirëpritur për ato kompani që donë vetëm të kryejnë aktivitete të hulumtimit dhe të marketingut në treg, atëherë për ato kompani që më herët kanë qenë të detyruara të regjistrojnë shoqërinë e huaj tregtare si degë të lejohet një periudhë kalimtare që ato degë t'i shndërrojnë në zyra të përfaqësisë.

Këtë koment dhe komentet tjera patjetër se do t'i dorëzojmë edhe me shkrim deri në datën e caktuar dhe më shumë nuk do të doja t'ju marrë kohë.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni!

ILJAZ RAMAJLI: Kërkoj falje, e mora fjalën për të dytën herë, por janë dy çështje. Një, problemi më i madh në praktikë edhe për gjyqet është adresa e biznesit. Nuk kemi mbërrirë të sigurojmë, meqë Ligji nuk përmban dispozita ndëshkuese, biznesin qysh ta detyrojmë që në afatin prej 10 ditëve t'i bëjë ndryshimet.

Unë e kam dhënë një propozim, pra që çdo ndryshim të bëhet brenda 15 ditëve, sepse nuk është e përkufizuar tash. Thotë – duhet të bëhet, për 15.

Pra, nuk ka dispozita ndëshkimore dhe unë s'di qysh do t'i detyrojmë, sepse problemi më i madh është ky.

E dyta, te shqetësimet që i kanë jo vetëm bankat, por çdo investitor i huaj, çdo partner me një punë ekonomike rreth vërtetësisë së dokumenteve nuk mund të zgjidhet metoda administrative me metodën konstituive. Duhet njëra ose tjetra.

Unë ju thashë se e kanë lëshuar krejt metodën konstituive, janë duke i ikur krejt sepse është veprim shtrëngues. Me një shtet, që s'po e përmendi, në 2002 ka qenë dashur para se të regjistrohet t'i sigurojë 22 dokumente prej organeve të ndryshme. Ajo e ka komplikuar punën shumë.

Por, shqetësimi i bankave është, por tash është barem sa i përket metodologjisë së ALM-së, dhe ju e dini dhe aplikoni, dhe njeh klientin, do të thotë dy të reja që tash po bëhen.

Pra, ishte një disproporcion që e pashë tash në mes zgjidhjeve ligjore që i kemi dhënë. Për degën, propozuesi ka aplikuar direktivën e BE-së për zbulimin e të dhënave të firmës amë, por nuk është e qartë a kërkohen edhe të dhënat për përfituesin fundor si person fizik te dega.

Tash është bërë një e padrejtë. Në qoftë se krijon një SHPK, nuk është kërkuar për firmën e huaj zbulimi i të dhënave në përputhje me direktivën e Bashkimit Evropian për zbulimin e të dhënave deri te përfituesi fundor – person fizik.

Po kjo, te dega ka mbetur formulimi qysh është i dhënë në Ligjin për bankat, kur të regjistrohet banka dhe në Direktivën për zbulimin e të dhënave të përfituesve fundorë.

Te SHPK-ja dhe te shoqëria aksionare në këtë ligj nuk e kemi një kërkesë të tillë që firmat e huaja aksionare që janë aty të bëjnë zbulimin e të dhënave me rastin e regjistrimit. Mirëpo, kjo për degën qysh ka shkuar deri në 5% të aksioneve, pak do të jetë problematike sepse deri tash e kemi pasur të përcaktuar vetëm për bankat dhe kompanitë e sigurimeve, e tash po bëhet për çdo degë që hapet këtu dhe duhet zbulimi deri te përfituesi fundor si person fizik.

Do të hapë pra probleme procedurale të regjistrimit. Është penguese.

REMZIJE HAJDARI: Nëse më lejohet, zoti kryetar!

KRYETARI: Gjithsesi! Urdhëroni!

REMZIJE HAJDARI: Faleminderit të gjithëve për komentet dhe propozimet që i dhatë lidhur me Projektligjin.

Desha vetëm një sqarim shtesë sa i përket listimit të direktivave. Qeveria e Kosovës, respektivisht ministritë punojnë mbi bazën e dy akteve nënligjore – të Rregullores së Punës të Qeverisë dhe Rregullores për Standarde të Hartimit të Akteve juridike, që decidivisht na thotë: në nenin 1, paragrafin 2 duhet të shkruhet se ky projektligj është në përputhje të plotë ose të pjesërishtme të direktivave ose rregullores si në vijim.

Në rastin konkret pse është pjesërisht dhe e kemi marrë opinionin nga Ministria e Integriteteve Evropiane, ku thuhet – direktiva për kapitalin themeltar nuk është transpozu plotësisht, sepse aty thotë 25.000, e ne e kemi marrë 10.000 euro.

Kjo është sepse na është lëshuar opinionin ligjor që është pjesërisht në përputhje. E kemi standard t'i listojmë. Kur të heqet prej Rregullores së Punës të Qeverisë, që është nënshkruar prej kryeministrit dhe ne nuk i listojmë, mirëpo tash duhet patjetër t'i listojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni...!

ILJAZ RAMAJLI: Jo detyrimisht, në ligj mundeni me memorandum shpjegues...

(Ndërhyrje)

Sepse unë si jurist, pastaj dua të kërkoj që nëse ju e keni bërë këtë ligj në frymën e tillë dhe në këtë ligj nuk gjej përgjigjet, atëherë shkoj ta marrë direktivën të implementoj.

REMZIJE HAJDARI: E kemi detyrimisht të përcaktuar me Rregullore të punës të Qeverisë, dhe ashtu thotë.

(Ndërhyrje)

ILJAZ RAMAJLI: Shikoni! Këtë që e diskutuam nuk po e vëmë në dyshim se a e keni detyrim. Formulimi që e keni dhënë është ambivalent. Mua si aksionar me një shoqëri, kur s'më konvenon ligji, do të shkoj ta bëj dhe thirrrem në direktivën që ju e keni cituar këtu.

Ju e keni cituar se pjesërisht cilat pjesë duhet të definohen për t'u aplikuar direkt. Unë po ua lexoj Ligjin e Sllovenisë, nenin 2.

Dëgjoni çka thotë: "Transportohen direkt dhe implementohen si ligj vendor direktivat e Bashkimit Evropian si më poshtë"...

Pra, formulimi pjesërisht, ne dhe kolegu im po flasim si avokatë dhe kur t'më vjen rasti e s'më pëlqen mua ligji, unë pjesërisht atje e zgjedh se cila pjesë do t'më pëlqej mua.

Unë jam të mbetem këtu, por veç të thuhet se cilat pjesë.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni!

KRESHNIK KURTISHI:

Faleminderit kryesues! Jam Kreshnik Kurtishi na Projekti i USAID-it – Partneriteti për zhvillim.

Vetëm desha të ndërlihem me komentën që e dha zotëri Ramajli për natyrën e regjistrimit. Pra, është plotësisht e vërtetë se shumica e shteteve janë duke shkuar nga natyra administrative e regjistrimit dhe regjistrimi i bizneseve bëhet në agjencitë administrative.

Duhet të kemi të qartë një gjë që plani për zbatimin e MSA-së ka paraparë përafrimin sa më të madh me direktivat e Bashkimit Evropian dhe direktivat për regjistrat e bizneseve, por regjistrat e bizneseve në Bashkimin Evropian nuk e parasheh regjistrimin administrativ formal dhe përgjegjësinë e plotë të bartur nga ana e regjistruarëve.

Pra, duhet të ketë një lloj përgjegjësi organi administrativ i cili e bën pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e shoqërisë tregtare në regjistër.

Prandaj, për këtë arsye, do të thotë se edhe ka ndryshuar formulimi këtu, por me disa përmirësime tjera për t'u lehtësuar aplikuesve përdorimin e modeleve dhe përdorimin e formulave të ndryshëm që ta bëjnë më shpejt.

Pra, te shembulli për regjistrimin e kësaj forme, siç është dhënë këtu, është në shtetin e Estonisë, ku regjistrimi bëhet për 2 ditë, dhe e kanë formulimin pak a shumë të ngjashëm me formulimin

që është dhënë këtu. Po ashtu, desha të ndërlihem edhe në disa pika tjera të ngritura. Ndoshta ligji është shumë voluminoz, i ka mbi 170 faqe një gjuhë, dhe shpesh humbin dispozitat nga një vend në vend tjetër.

Lidhur me atë që tha përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ju kisha referuar nenit 5, paragrafi 3 dhe nenit 17 paragrafi 3 i cili përcakton se format tjera të regjistrimit të bizneseve mund të regjistrohen në ARBK mirëpo natyra juridike e organizimit të atyre formave, siç është për shembull në ndërmarrjet sociale, përcaktohet me ligjin përkatës tuajin.

Pra, nuk ka nevojë të përsëritet këtu një formë e veçantë, kur është rregulluar me ligj të veçantë dhe është thënë në ligj se kur ka nevojë të definohen specifikat e regjistrimit të ndërmarrjeve sociale, atëherë kjo mund të bëhet me udhëzim administrativ i cili nxirret në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin për ndërmarrjet sociale nga ana e Qeverisë dhe në bashkëpunim në mes dy ministrive.

Në lidhje me komentin për detyrimin e moskonkurrencës, desha të siguroj kolegun se ky ka qenë koment i njëjtë edhe nga Banka Botërore që është dhënë edhe për detyrimet e besnikërisë dhe moskonkurrencës, konfliktit të interesit e tjera, për këtë arsye në ligj edhe është shtuar një kapitull i tërë i cili e rregullon këtë çështje.

Pra, ju kisha referuar te neni 258, që është për ortakëritë, SHPK-të dhe shoqëritë aksionare, kapitull i tërë, te neni 258 i ligjit ku thuhet se aksionarët brenda SHPK-ve, SHA dhe ortakët brenda ortakërive të përgjithshme dhe ortakërive të kufizuara, neni 258 paragrafi 2, nënparagrafi 2.4 dhe 2.5.

Thotë: Detyrimi për besnikëri dhe përgjithshmëri përfshin por nuk kufizohet në detyrimin për mospërvetësimin e mundësive afariste të ortakërisë ose korporatës, moskonkurrimin afarist me ortakërinë ose korporatën.

Pra është fjala për moskonkurrimin e aksionarëve apo të ortakëve që janë brenda korporatës me korporatën, për shkak se nuk mund t'u ndalojmë atyre personave që të hapin shoqëri tregtare të veçanta.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Ramajli, i cili ceku problemin e dispozitave ndëshkuese, për shembull.

Pra, në qoftë se si organizatë biznesore apo shoqëri tregtare nuk e ka adresën e saktë ose e ka ndryshuar dhe s'u lajmërua, çfarë sanksioni e rrokë atë, me cilin ligj e rrokë.

Ndërhyrje.....: Kryetar, vetëm kisha dashur ta bëj një sqarim, se kjo ndoshta është me rëndësi.

Pra, u përmend çështja e raportimit, sepse zgjidhja në këtë pyetjen tuaj është që të obligohen bizneset për të raportuar në baza vjetore dhe të informojnë apo japin informata....

KRYETARI: Jo në baza vjetore, por si ta ndërrojë adresën duhet të vjen e tregojë.

Ndërhyrje: Mirëpo, definitivisht është edhe obligim të vjen të tregojë se e ka ndryshuar adresën.

KRYETARI: Por, nëse s'e bën atë punë, si ndëshkohet?

Ndërhyrje.....: Nëse s'e bën, nuk ka ndëshkim. Mirëpo, agjencia e regjistrimit të bizneseve e ka të drejtën e korigjimit të informatave dhe këto informata mund t'i marrë nga Këshilli për raportim financiar kur raportojnë korporatat në baza vjetore.

KRYETARI: Po, ato janë vetëm disa prej tyre, nuk janë të gjithë të obliguar të raportojnë.

Ndërhyrje.....: Mund t'i marrë nga ATK-ja ku obligohen të gjithë të raportojnë.

KRYETARI: Mirë! Kjo çështje është për diskutim në grup punues, dhe do ta diskutojmë.

(Ndërhyrje)

Jo, problemi ekziston.

(Ndërhyrje)

Po, veç për atë edhe po them, a kemi me ligj tjetër që e rregullon këtë?

ILAZ RAMAJLI... Nuk kemi, sepse tash e pashë një dispozitë dhe nëse po e parafrazoj... Thotë, edhe palët e treta, në qoftë se kanë njohuri për mospërputhje të dhënave që janë në regjistër, mund të kërkojnë nga regjistri ndryshimin e të dhënave. Kjo është një gjë e mirë, do të thotë, sepse mundëson që të bëhet ndryshimi. Mirëpo, problemi ekziston.

KRYETARI: Problemi ekziston dhe këtë ne e kemi theksuar në Komision kur kemi diskutuar.

Unë e di që ne duhet t'i regjistrojmë bizneset shpejt dhe sa më shpejt, e mos me i penguar, dhe kjo është intenca. Për 2, ditë, 3 ditë apo 1, e 4 ditë, për mua nuk është shumë esenciale, vërtet.

Mirëpo, hajde për 2 ditë po domi të dalim të parët, e edhe 1 ditë le t'i bëjmë, mirëpo në qoftë se dikush ka ardhur dhe të ka prezantuar ty të dhëna të rrejshme për një biznes ose jo, ai duhet të përgjigjet diku, pra nëse ti ia ke lënë atij në besim.

Dhe duhet të ketë një përgjegjësi diku, ose me një ligj tjetër, që e rrokë ndoshta ai ligj tjetër.

Pra, pajtohem që në këtë ligj ndoshta s'është e natyrshme të kihet shumë këso dispozita ndëshkuese, por unë e di dhe Vërtyti e ceku disa herë që shpeshherë ka kontekste, shpeshherë ndodhin të ndërrohen edhe raportin midis themeluesve bile, pa e ditur themeluesi tjetër. Pra, pa e ditur hiq, ka ndodhur. Është shkuar atje, sepse s'i ke ti të shtrënguara këto sende.

(Ndërhyrje)

Po, e kthen por boll se krijohet problemi.

(Ndërhyrje)

ILJAZ RAMAJLI: Kërkoj falje! Ka përvojë në ARBK... Në kërkesën e cilëso palë se është bërë një ndryshim në mënyrë të kundërligjshme e kthen në gjendjen e mëparshme...

(Ndërhyrje)

Menjëherë, sipas procedurës administrative dhe pala ka të drejtë të bëjë kallëzim penal për deponim të rrejshëm.

Vetëm edhe një fjalë. Te firmat që s'kanë aktivitet, ju lutem! Nuk duhet provuar të shuhen ato. Koncepti i biznesit është se unë e regjistroj një firmë dhe e pres shansin kur t'më jepet për të zhvilluar biznes. Bile, të ju them, praktikat në shumë vende, zyrët e avokatisë regjistrojnë firma në emër të zyrës së avokatisë, që janë në pritje, meqenëse procedurat në disa shtete janë të vështira dhe investitori që vjen nga jashtë e blen këtë firmë që është e regjistruar te ai dhe vazhdon të punojë.

Por, unë e di që në qoftë se provojmë, së pari është vullnet i palës, se hej, qysh mundesh, në qoftë se unë s'e kam shkelur asnjë ligj dhe kam raportuar zero-zero në administratë tatimore, kush është ai që do t'ma mbyll biznesin, pse unë s'paskëm aktivitet ekonomik?

Ndërhyrje:Vetëm ta bëjmë një ndarje! Do të thotë, sanksionet për mosraportim të ndryshimit të adresës, ndryshimit i drejtorit, ndryshimit të dhënave elementare, duhet të ndëshkohet.

Këtu nuk na ndihmon as Kodi penal, sepse s'është vepër penale, por këto të dhëna nëse nuk ndryshohen duhet të parashihet një dispozitë e cila i ndëshkon ato biznese që nuk i aktualizon.... Përndryshe nuk bën.

Kolegu Ramajli, që tha, është në rregull sa i përket asaj që bizneset të regjistrohen, dhe pajtohem me të, por ato të cilat nuk kanë aktivitet të mos shuhen automatikisht por me një kusht në qoftë se ata raportojnë, e nëse s'raportojnë ti nuk e di a funksionojnë apo s'funksionojnë. Është e vërtetë, quhen – shelf companis...

Zyra e avokatisë atë e themelon, mirëpo ato dorëzojnë raportin, qoftë edhe me zero, qoftë edhe me joaktivitet e dorëzon raportin në fund të vitit dhe thotë unë nuk jam aktiv. Dhe aty në regjistrë shkruan se nuk është aktiv.

Dhe, kushdo që do të bëjë biznes me të, e sheh se nuk është aktiv.

ILJAZ RAMAJLI: Atë, Administrata Tatimor ee ka të rregulluar atë.

Ndërhyrje.....: Po, s'është me rëndësi! Me rëndësi është personi i cili identifikohet prej dikujt, të dijë se çfarë është puna e atij investitori.

(Ndërprerje e incizimit)

MENTOR HAJDARAJ: Faleminderit zoti Mustafa!

Jam Mentor Hajdaraj, kryesues i Komitetit Ligjor të Shoqata e Bankave.

Nëse më lejoni, për të kuptuar rëndësinë e vërtetësisë së dokumentave, e kisha marrë një shembull shumë praktikë që ne çdo ditë e hasim në bankë, dhe është shumë problem i madh.

E kemi një kompani që punon me bankë 10 vjet, dhe pronar është Mentor Hajdaraj. Ai ka qarkullim vjetor 5 milionë euro, ka produkte kreditore 3 milionë euro, po ka edhe mjete të deponuara në bankë, të themi 2 milionë euro. Dhe, pas 10 vjetëve, një ditë prej ditësh vjen Ilir Gaxha dhe thotë: – ndryshone këtë biznes sepse ky nuk është Mentori por është Iliri. Dhe, ne i lypim dokumentat shtesë. Ai thotë, nuk ke nevojë t'i kërkosh sepse është në ARBK,ka bërë ndryshimin.

E për ne tash është shumë relevante, a do të kthehet në gjendjen e mëparshme apo do të përgjigjet ai vetë penalisht pse po e bën këtë.

Për derisa ne ia lejojmë vetëm me këtë faktin se është regjistruar në ARBK me i tërheq ai 2 milionë dhe këtë qarkullimin me marrë e me shkua jashtë vendit diku, atëherë përgjegjës kryesor do të jetë banka sepse gjykata do të konstatojë se banka ose nuk e ka bërë kujdesin e shtuar të refikojë dokumentet ose ka marrë kompetencën e krejt organeve kompetente për të vendosur a është bërë në mënyrë të ligjshme kjo bartje e aksioneve apo jo.

Versioni më i mirë është kur klientët sjellin kontratat e shit-blerjes së aksioneve, vendimin e aksionarëve, aneks-statutet e ndryshimit të aksioneve, por edhe ky nuk është fakt i mjaftueshëm për ne sepse ato bëhen jashtë zyrave të bankës dhe ne nuk e dimë ish-aksionari a e ka nënshkruar vetë apo jo, apo është falsifikuar nënshkrimi.

Për atë arsye,po ju lus të merret shumë seriozisht kjo çështje, jo ndoshta të bëhet në stilin konstitiiv, që të bëhet edhe auditorët që u përmendën më herët, por të paktën të shkohet te noteri të legalizohen këto dokumente dhe të paktën bankat të sigurohen se një organ kompetent e ka vërtetuar nënshkrimin e ish aksionarit se me vullnetin e lirë po ia bartë aksionet aksionarit të ri. Pra, të paktën, kjo të bëhet.

Ose, ndonjë version tjetër, nëse mund të gjendet.

KRYETARI: Urdhëroni!

ILJAZ RAMAJLI: Shikoni, unë i kuptoj kërkesat e bankave për shkak se ata donë siguri. Por, me asnjë dispozitë nuk guxon të shkelet parimi i ligjshmërisë, parimi i vullnetit të palëve.

Nuk mundet banka mua t'më përcaktojë a kam me i shitur aksionet apo jo. Më falni!

Por, nga përvoja, po të tregoj sepse unë punoj për nja 10 fonde financiare të jashtme, që i financojnë këto mikrofinancat, dhe tjera.

Për t'u siguruar kjo, ne i marrim peng aksionet, dhe kur t'i kesh peng aksionet, nuk mund të ndryshohet. Kjo është një formë rrethanore e zgjidhjes së problemit, por unë s'mund të imagjinoj se banka pa vë peng në aksione do t'më kufizoj mua të drejtën për të shitur aksionin, shembull aksionin, apo komplet biznesin në qoftë se është biznes individual.

Sa i përket vërtetimit të noteri i dokumenteve, ai është kthim prapa 10 vjet. Pra, kushdo që e kërkon është kthim mbrapa 10 vjet dhe ngarkim i biznesit me shpenzime pa filluar aktiviteti i biznesit.

Tash përmes AML metodologjisë dhe një biznesi që ju e dini se janë vënë në fuqi, ju vetë duhet të dhe gavordi diligjens duhet të vihet deri te vetat për biznesin të cilit doni t'i jepni kredi, ose mos mundëshi ju, angazhoni avokat.

(Ndërhyrje – polemikë)

KRYETARI: Pra, na i çoni ju vërejtjet me shkrim dhe do të punojë grupi punues, sepse s'mundemi sot t'i zgjidhim këto probleme. Nëse do, urdhëro, por shkurt!

Ndërhyrje.....: Me rëndësi është të kuptohet se ne nuk po kërkojmë të qesim veto a të shiten aksionet apo jo. Por nëse ne na vjen një kontratë e shitblerjes së aksioneve jashtë zyrave të bankës, jashtë vërtetësisë së atyre nënshkrimeve prej një organi kompetent, ne nuk jemi të sigurt se ky ish aksionari a e ka nënshkruar vet apo personi që po paraqitet si aksionar e ka falsifikuar edhe atë nënshkrim, sepse ARBK po e lejon edhe ashtu të bëjë ndryshimin.

KRYETARI: Po mirë, nëse ai i ka lënë peng, ai s'mundet t'i shetë, e në qoftë se s'i ka lënë peng, ju s'mund ta pengoni.

Pra, unë s'po ju kuptoj juve çka po doni. Duhet të mirret vendimi nga bankat a me e i shit a jo?! Po nuk mund të krijojmë ne administrim ashtu.

Ndërhyrje.....: Jo, por problemi është se ARBK bën ndryshimin pikërisht ku është problemi.

KRYETARI: Në qoftë se i ka lënë peng aksionet dhe Iljazi po e shpjegon shumë mirë, e në qoftë se s'i ka lënë peng ne s'mund të krijojmë pengesë administrative.

(Ndërhyrje)

E po mirë, dërgoni ju me shkrim dhe i arsyetoni, dhe i shohim ne, sepse sot s'mund ta zgjidhim këtë problem. Urdhëroni a doni edhe për ndonjë sqarim dhe po e përfundojmë për sot?

Ndërhyrje.....: Po, tek çështja që u përmend, te mbyllja e bizneseve. Pajtohemi plotësisht se nuk është e paraparë mbyllja e bizneseve këtu, pavarësisht a je aktiv apo jo aktiv. Është paraparë që të kalojë në një listë pasive bizneset. Pra, në atë që e thatë edhe ju, do të thotë të mos mbyllen bizneset. Është ky koment që e kemi bërë...

KRYETARI: Po, do të shohim këtë problem. Atëherë, ju falënderoj të gjithëve, e në qoftë se dikush tjetër të shtojë diçka, atëherë ne jemi këtu edhe ta dëgjojmë...

(Ndërhyrje)

A jeni të Ministrisë ju? Atëherë, ju ministritë keni mund të punoni kur është kryer ligji, jo tash.

Atëherë, nëse po doni, mund ta merrni fjalën!

KRYETARI: Mirë! Na i dërgoni me shkrim deri të hënën, në fund të orarit, ju lutem, dhe ne në rast nevojë ju thërrasim në grup punues për t'i arsyetuar.

Kjo ishte kërkesa jonë, jo të martën. Dikush e ka kuptuar për të martën, e unë ju kisha lutur se deri të hënën pas dite, në fund të orarit. Por, nëse veç thoni, le të jetë deri në të martën në fund të orarit të punës. Pra po e zgjasim një ditë, le të bëhet kjo deri në të martën, në fund të orarit të punës, na i dërgoni të gjitha vërejtjet që i keni, me arsyetime, sipas nevojës dhe materies në rast nevojë edhe do t'u thërrasim në grup punues me i diskutuar ato vërejtje, për autorin e propozimeve.

Pra, ne duhet të mos ngutemi, mos të bëjmë këtë në dëm të kualitetit, por duhet të ngutemi se e kemi afatin kur duhet ta aprovojmë ligjin. Pra, e kemi caktuar nga Kuvendi që të jetë 11 maj, dita e fundit.

Ju faleminderit!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë.